

Raporti monitorues i keqinformimit për muajin prill

2024

maj 2024

Action for
Democratic Society
hibrid.info



Raporti monitorues i keqinformimit për muajin prill

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, maj 2024

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



Përmbajtja

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Llojet e mediave sociale

Figurat dhe Institucionet më të përfolura

Kontrulli dhe vlerësimi i deklaratave

01. 02. 03. 04. 05. 06. 07. 08.

Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkrues pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë muajit prill 2024, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Formati i këtij raporti është i pari dhe i vetmi i llojit. Është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i 22-të mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma hibrid.info e specializuar në kontroll të fakteve, edukim digjital dhe medial, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Në këtë raport monitorues jepet një pasqyrë për formën e përmbajtjeve me karakter informues për dhe rreth ngjarjeve në Kosovë. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të japë një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.

Kategoritë monitoruese janë:


- Vlerësimet e artikujve keqinformues;
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese;
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues;
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e mediave sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e publikuesve në mediat sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues;
- Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave.

Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info, e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti, është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese



Bazuar në monitorimin dhe trajtimin e 68 përmbajtjeve keqinformuese gjatë muajit prill 2024, është evidentuar se dezinformatat kanë qenë kategoria kryesore e keqinformimit, me 25% të të gjitha përmbajtjeve keqinformuese. Kjo kategori pasohet nga përmbajtjet e paverifikuara me 22%, ndërsa mashtrimi është radhitur me 15% të përmbajtjeve keqinformuese gjatë këtij muaji.

Gjatë muajve shkurt dhe mars të vitit 2024, artikujt "clickbait" kishin dominuar për shkak të një shumësie të keqinformatave të publikuara nga fusha e politikës, kronikës së zezë dhe sferës sociale janë vlerësuar me këtë kategori. Megjithatë, gjatë muajit prill, keqinformacioni nga politika dhe siguria janë vlerësuar si dezinformatë. Kjo është për shkak të faktit që gjatë këtij muaji, keqinformacioni nuk është përqendruar në një temë specifike që ka marrë përqendrimin kryesor, por disa përmbajtje keqinformuese me tematikë politike dhe të sigurisë janë vlerësuar si dezinformatë.

Dezinformatat pasohen nga përmbajtjet e paverifikuara me 22%, të cilat janë dyfishuar krahasuar me muajin mars (nga 11% në muajin mars 2024, në 22% në muajin prill 2024). Përmbajtjet e paverifikuara u publikuan në media sociale dhe media reale, përfshirë këtu dominimin e përmbajtjeve me tematikë të sigurisë, sociale e politikës.

Në vendin e tretë radhiten përmbajtjet mashtruese me 16%, të cilat kanë shënuar rritje prej 3% krahasuar me muajin mars (nga 13% në muajin mars 2024, në 16% në muajin prill 2024).



25% e artikujve keqinformues të trajtuar kanë marrë vlerësimin "dezinformatë"

Analizë e llojeve të vlerësimeve

1.1

01. Dezinformatë

Pothuajse të gjitha dezinformata janë publikuar nga faqe dhe llogari në mediat sociale (21%), përfshirë edhe dezinformata të publikuara në portale informative dhe atyre të dyshimta. Sa u përket fushave, prijnë dezinformatat nga tema të sigurisë (10%), politikës (9%) dhe sociale (4%). Përderisa në portale informative u publikuan dezinformata lidhur me pretendimin se ISIS kërcënon Kosovën dhe Shqipërinë, si dhe deklaratë të pathënë për Lajçak se BE-ja do ta humbë Kosovën nëse nuk e merr me vete.

03. Mashtrim

Të gjitha përmbajtjet mashtruese janë publikuar nga faqe dhe llogari në media sociale. Këto përmbajtje ishin nga fusha sociale (9%), politike (6%) dhe sporti (1%). Përmbajtjet mashtruese ndërlidheshin me publikimin e produkteve me pretendimin se shërojnë sëmundje të ndryshme, si dhe publikime në media sociale me pretendimin për dhënie kredish. Po ashtu, janë publikuar edhe manipulime të zërit të videos ku shihet ish-presidenti, Hashim Thaçi, si dhe imazhi i kryetarit të PSD-së, Dardan Molliqaj, me idenë se japin vlerësime për kryeministrin, Albin Kurti.

02. Përmbajtje e paverifikuara

Përmbajtjet e paverifikuara u publikuan nga faqe dhe llogari në media sociale dhe në portale të dyshimta. Këto përmbajtje kryesisht ishin nga fusha e sigurisë (9%), sociale (6%) dhe politikës (3%). Sulmi i Iranit ndaj Izraelit i bërë në mesnatën e 13 prillit, ishte tema për të cilën më së shumti u publikuan përmbajtje të paverifikuara nga faqe në media sociale. Nuk munguan edhe tema tjera për të cilat u publikuan përmbajtje të paverifikuara si, pretendimi për muralin e futbollistit Vedat Muriqi në qytetin e Mallorca-së, sondazhe për zgjedhje, ndërlidhur me deklarinimin e presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq për të cilin u pretendua se e përmend bashkëshortin e presidentes Osmani gjatë fjalimit, etj.

04. Clickbait

Pothuajse të gjitha përmbajtjet “clickbait” janë publikuar në portale informative ndërlidhur me tema nga fusha e kronikës së zezë, sociale dhe sportit. Përmbajtjet nga kronika e zezë kishin të bënin me ngjarje tragjike dhe lajm të vjetër, për të cilat në titull nuk bëhet e ditur vendndodhja e ngjarjes. Edhe për temat sociale, si për pensione dhe probleme familjare, si dhe rreth shkuarjes në Gjermani për 1 maj, u përdorën tituj përgjithësues dhe jo sqarues.

05. Lajm i rremë

Lajmet e rreme u publikuan në media sociale nga fusha politike (4%), sociale (3%) dhe ajo e sigurisë (1%). U publikuan në media sociale video të presidentit të ndjerë të SHBA-ve, John Kennedy me pretendimin e rremë se ai është gjallë. Lajme të rreme u publikuan edhe për uljen e çmimit të bukës dhe se Bujar Osmani është shprehur se shqiptarët duhet të flasin vetëm serbisht.

06. Teori konspirative

Pothuajse të gjitha teoritë konspirative janë publikuar në media reale në gjuhën serbe. Këto përmbajtjet ndërlidheshin me incidente dhe zhvillime në veri dhe vendbanime me shumicë serbe, incidente për të cilat nuk dihet qëllimi dhe kryerësit e veprës, por që, Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë i interpreton si tendencë për spastrim etnik të serbëve.


Artikuj të tjerë me përmbajtje keqinformuese janë vlerësuar në kategoritë: gabim, manipulim i fakteve, clickbait/dezinformatë, mashtrim, përmbajtje e paverifikuar/dezinformatë.

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

2

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave




Sulmi me dronë i mesnatës së 13 prillit nga ana Iranit drejt Izraelit, ka ndikuar që të dominojnë përmbajtjet e paverifikuara të publikuara nga faqet të ndryshme në mediat sociale lidhur me këtë temë. U publikuan kryesisht video nga zhvillime tjera me pretendimin se paraqesin momente nga sulmi i Iranit drejt Izraelit. Ashtu si konflikti Izrael-Hamas kur ishte radhitur si një nga temat kryesore për të cilën u keqinformua gjatë muajve tetor-janar, edhe ky sulm i Iranit ndaj Izraelit tregon se këto zhvillime ndërkombëtare me peshë përdoren për të keqinformuar në media sociale.

Ndërkaq, konflikti Izrael-Hamas i nisur me 7 tetor të vitit të kaluar (2023) vazhdon të përdoret si temë për keqinformim. Edhe gjatë këtij muaji janë publikuar disa përmbajtje të paverifikuara dhe dezinformata ndërlidhur me konfliktin.

Përmbajtjet e koduara si raste tragjike (vdekje e vrasje), ku përveç artikujve “clickbait” për të cilat nuk bëhet e ditur në titull vendndodhja e ngjarjes, janë publikuar edhe lajme të vjetra me pretendimin të paraqiten si aktuale.

Në kuadër të përmbajtjeve keqinformuese të gjetura gjatë këtij muaji, janë trajtuar edhe keqinformata lidhur me temën e produkte për të cilat pretendohet se shërojnë disa sëmundje. Krahas këtyre, janë publikuar edhe përmbajtje mashtruese me pretendime të rreme për dhënie kredish, si the teori konspirative lidhur me incidentet në vendbanimet më shumicë serbe.



28% e temave kryesore janë për sulmin e Iranit ndaj Izraelit, konfliktin Izrael-Hamas, raste tragjike, produkte shëruese, dhënie kredish dhe veriu.

Analizë e kontroleve të fakteve sipas temave

2.1

Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara nga media dhe publikues të ndryshëm, sipas matjeve të platformës hibrid.info, përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

01. Sulmi i Iranit ndaj Izraelit

Të gjitha përmbajtjet ndërlidhur me sulmin e Iranit ndaj Izraelit janë publikuar nga faqe në Facebook në gjuhën shqipe. Këto përmbajtje ndërlidheshin me tema nga fusha e sigurisë, të cilat janë vlerësuar si përmbajtje e paverifikuar. Kështu u vlerësuan për faktin se janë publikuar video-materiale me pamjet nga lufta Siri, sulme në Krime dhe nga konflikti Izrael-Hamas me pretendimin se paraqesin pamje nga sulmi i Iranit ndaj Izraelit. Po ashtu, u publikuan edhe video-materiale ku shihen qytetarët në aeroport apo edhe në rrugë duke lëvizur, me idenë se paraqesin panikën dhe frikën e qytetarëve izraelit pas sulmit.

03. Raste tragjike

Përmbajtjet keqinformuese për raste tragjike (vdekje, vrasje) janë publikuar në media reale dhe media sociale nga fushë e kronikës së zezë. Në portale informative u publikuan artikuj lidhur me përplasjen e një 2-vjeçareje me veturë dhe sulm me thikë në një shkollë, ngjarje këto të ndodhura jo në Kosovë, por që në titujt e këtyre artikujve nuk bëhej e ditur vendndodhja e ngjarjes.

02. Konflikti Izrael-Hamas

Përmbajtjet lidhur me këtë temë janë publikuar nga faqe në media sociale, konkretisht në Facebook. Këto përmbajtje ishin nga fusha e sigurisë, politikës dhe sociale të cilat u vlerësuan si dezinformatë, përmbajtje e paverifikuar dhe përmbajtje e paverifikuar/dezinformatë. Dezinformatë u vlerësuan dy imazhe të gjeneruara me inteligjencë artificiale ku shihet kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu i shtrirë në spital dhe pranë një mështjerre si “mesazh” për xhaminë Al-Aksa. Ndërsa përmbajtje e paverifikuar është vlerësuar imazhi i gjeneruar me inteligjencë artificiale me pretendimin se paraqet fëmijët në Gaza, si dhe publikimi i një fotografie të vitit 2017 me pretendimin se paraqet gjendjen në Gaza, e që është vlerësuar si përmbajtje e paverifikuar/ dezinformatë.

04. Vendbanimet me shumicë serbe

Keqinformatat lidhur me këtë temë janë publikuar në mediat reale në gjuhën serbe duke iu referuar komunikatave të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë lidhur me incidentet në vendbanimet me shumicë serbe. Këto përmbajtjet nga fusha e sigurisë janë vlerësuar si teori konspirative për faktin se Zyra, incidentet e ndodhura në vendbanimet me shumicë serbe, përkundër faktin që nuk dihet qëllimi dhe kryerësit e veprës, i interpreton pa fakte si projekt i Prishtinës zyrtare për spastrim etnik të serbëve.


3

Llojet e fushave

Në bazë të monitorimit dhe gjetjeve të përmbajtjet keqinformuese të trajtuara gjatë muajit prill del se publikues të ndryshëm (media reale, portale të dyshimta dhe mediat sociale) kanë prodhuar dhe shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese në fushën e sociale.

FUSHAT KRYESORE

Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore



Përderisa fusha sociale, gjatë muajit të kaluar (mars) është radhitur si e dyta me 26%, gjatë këtij muaji (prill) keqinformatat nga kjo fushë kanë shënuar rritje prej 6%, duke bërë që kjo fushë të radhitet si e para me 29%. Publikimi i keqinformatave në një shumëllojshmëri të temave për çështje sociale si, çmimi i bukës, pensionet, dhënie kredish, emigrimi, produkte shëruese, sigurimi shëndetësor etj, ka bërë që kjo fushë të prijë gjatë muajit prill. Pjesa e konsiderueshme nga fusha sociale janë vlerësuar si mashtrim (9%), përmbajtje e paverifikuar (6%), clickbait (4%) dhe dezinformatë (4%).

Fusha e sociale pasohet nga ajo e sigurisë e cila ka shënuar rritje prej 7% krahasuar me muajin mars (nga 21% në muajin mars, në 28% në muajin prill). Sulmi i Iranit ndaj Izraelit, zhvillimet në veri dhe vendbanimet me shumicë serbe, kërcënimi i ISIS dhe të tema të tjera për të cilat u keqinformua, kanë ndikuar që fusha e sigurisë të radhitet si e dyta. Shumësia e përmbajtjeve keqinformuese nga kjo fushë është vlerësuar si dezinformatë (10%), përmbajtje e paverifikuar (9%) dhe teori konspirative (4%).

Fusha e politikës, përkundër faktit që në muajin mars ishte e para në radhitje me 27%, gjatë këtij muaji ajo ka pësuar një rënie të lehtë prej 1% (26%) dhe radhitet si e treta pas sociale dhe sigurisë. Temat të ndryshme ndërlidhur me politikën si, anëtarësimi i Kosovës në KiE, Kosova dhe BE, Këshilli i Sigurimit, e tema të tjera janë përdor për të keqinformuar. Këto përmbajtje keqinformuese nga fusha politike janë vlerësuar si, dezinformata (9%), mashtrim (6%), lajm i rremë (4%) etj.

Në vendin e katërt radhiten keqinformatat nga fusha e sportit. Një pjesë e konsiderueshme e përmbajtjeve nga kjo fushë janë vlerësuar si clickbait, mashtrim, përmbajtje e paverifikuar, dezinformata, manipulim i fakteve. Murali i Vedat Muriqit, pretendime për largim nga futbolli të futbollistit Eros Grezda, pretendime se kënga “Mora fjalë” u këndua nga tifozët e Bayer Leverkusen për hirë të futbollistit të tyre, Granit Xhaka, janë disa nga temat për të cilat u keqinformua nga fusha e sportit.



83% e përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara janë nga fusha e sociale, politikës dhe sigurisë.

Llojet e publikuesve


4

Ashtu si në muajin paraprak (mars) kur kishin dominuar keqinformatat e publikuara në media sociale, edhe gjatë këtij muaji (prill) dominojnë përmbajtjet keqinformuese të publikuara nga faqe dhe llogari në media sociale. Në bazë të gjetjeve dhe trajtimeve të përmbajtjeve keqinformuese shihet një rritje prej 5% të keqinformatave të publikuara në media sociale krahasuar me muajin mars, (nga 61% në mars 2024, në 66% në muajin prill 2024). Kjo mund të shpjegohet nga fakti se pothuajse të gjitha dezinformatat, një pjesë e konsiderueshme e përmbajtjeve të paverifikuara dhe të gjitha përmbajtjet mashtruese dhe lajmet e rreme janë publikuar në media sociale.

Keqinformatat e gjetura dhe të trajtuara gjatë këtij muaji e që janë publikuar në media reale (portale informative) kanë përqindje të njëjtë me përmbajtjet e publikuara gjatë muajit të kaluar (mars). Kjo për faktin se të gjitha përmbajtjet gabim, një pjesë e konsiderueshme e artikujve “clickbait” dhe përmbajtjet e paverifikuara, përfshirë edhe teoritë konspirative, janë publikuar në media reale.

Ndërsa keqinformatat e publikuara në portale të dyshimta kanë shënuar rënie prej 5% krahasuar me muajin paraprak (nga 6% në mars 2024, në 1% në muajin prill 2024).

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES
TË PUBLIKUESVE ME
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE




99% e artikujve me përmbajtje keqinformuese janë publikuar nga publikuesit në media sociale (66%) dhe në mediat reale (33%).

Klasifikimi i publikimeve në gjuhën shqipe dhe serbe

Kjo matje tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues të monitoruar gjatë periudhës njëmuajore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhë të tjera në lidhje me raportimet e tyre për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE



Mostra e monitorimit dhe trajtimit të përmbajtjeve keqinformuese nga platforma “hibrid.info” fokusohet në keqinformatat në gjuhën shqipe të publikuara në media, portale të dyshimta dhe faqe e llogari në mediat sociale, si rezultat i së cilës gjatë muajit prill 2024, publikimet në këtë gjuhë mbizotërojnë në trajtim me 94%.

Ndërsa në gjuhën serbe monitorohen kryesisht vetëm raportimet keqinformuese në mediat reale, si dhe ato në median sociale “telegram”, lidhur me zhvillimet për dhe rreth Kosovës dhe trajtohen pikërisht ato përmbajtje. Në kuadër të muajit prill 2024, janë publikuar disa përmbajtje keqinformuese ndërlidhur me incidente në vendbanimet serbe dhe veri, duke përbërë kështu 6% të gjetjeve dhe trajtimeve të realizuara.

Analiza e artikujve të kësaj kategorie

5.1

Në këtë seksion të raportit analizohen publikimet keqinformuese të publikuara nga mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhët e tjera. Në vijim është përshkrimi i ndërlidhjes së tyre mes kategorizimeve, fushave dhe temave të trajtuara.

01. Publikimet në gjuhën shqipe

Më shumë se gjysma e përmbajtjeve keqinformuese të publikuara në gjuhën shqipe janë publikuar në media sociale (65%), ndërsa pjesa tjetër në media reale (2%) dhe portale të dyshimta (1%). Të gjitha përmbajtjet mashtruese dhe lajmet e rreme, dhe një pjesë e konsiderueshme e dezinformatave dhe përmbajtjeve të paverifikuara janë publikuar në media sociale. Ndërsa, në media reale janë publikuar të gjitha raportimet gabim, pothuajse të gjitha përmbajtjet “clickbait”, dhe një pjesë e përmbajtjeve të paverifikuara. Përderisa në media sociale dominojnë përmbajtjet keqinformuese nga fusha e sociale, sigurisë dhe politikës, në media reale socialja, sporti dhe kronika e zezë janë ato që prijnë si fusha.

02. Publikimet e mediave në gjuhën serbe (për dhe rreth Kosovës)

Të gjitha përmbajtjet keqinformues në gjuhën serbe janë publikuar nga mediat në gjuhën serbe duke iu referuar komunikatave publike të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë. Këto përmbajtje janë vlerësuar si teori konspirative dhe clickbait/dezinformatë. Si teori konspirative janë vlerësuar interpretimi pa fakte i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë të incidenteve në vendbanimet më shumicë serbe, e që përkundër faktit se nuk dihej qëllimi dhe kryesit e veprës, pretendimet janë se kjo po bëhet si frymëzuar nga Prishtina zyrtare më Albin Kurtin në krye.


Llojet e mediave sociale

Në këtë seksion analizohen vetëm artikujt keqinformues të publikuar dhe shpërndarë nga publikuesit në mediat sociale dhe në këtë rast nuk përfshihen publikimet në mediat tjera (mediat reale dhe portalet e dyshimta).

Gjatë muajit prill, 77% e përmbajtjeve keqinformuese në mediat sociale janë publikuar në Facebook, ndërsa 23% në TikTok. Ashtu si në muajin paraprak, kanë vazhduar të mbizotërojnë keqinformatat e publikuara në Facebook duke shënuar rënie të lehtë prej 4%. (nga 81% në mars 2024, në 77% në muajin prill 2024).

Ndërsa keqinformatat e gjetura dhe trajtuara e të publikuara në median sociale, TikTok kanë shënuar rritje prej 12% (nga 11% në mars 2024, në 23% në muajin prill 2024).

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË MEDIAT SOCIALE




Llojet e publikuesve në mediat sociale

6.1

Kjo matje, përmes të dhënave monitoruese, analizon ndërveprimin në mediat sociale sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues nga publikues të ndryshëm të mediave sociale. Kjo bëhet përmes këtyre kategorive kryesore të publikuesve: faqeve, llogarive, mediave dhe kanaleve që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale.

Përmbajtjet keqinformuese të gjetura dhe trajtuara në mediat sociale për muajin prill 2024 më së shumti u publikuan në faqe (51%), llogari (26%) në Facebook, pasuar nga llogari në TikTok (23%). Gjatë këtij muaji, nuk janë gjetur keqinformata të publikuara nga profile, faqe apo edhe media në media sociale.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË MEDIAT SOCIALE



6.2

Analiza e llojeve të publikuesve në mediat sociale

Në vijim analizohen këto kategori të mediave sociale në ndërlidhje me publikimet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

01. Facebook

Socialja (28%), siguria (26%) dhe politika (16%) janë tri fushat kryesore, për të cilat u keqinformua gjatë këtij muaji. Sa i përket kategorive, dezinformata (23%), përmbajtja e paverifikuar, mashtrimi (14%) dhe lajmet e rreme (12%). Në keqinformatat e publikuara në Facebook ka pasur një shumëllojshmëri temash të ndryshme nga fushat e lartcekura, por që kanë dominuar përmbajtje të paverifikuara lidhur me sulmin e Iranit ndaj Izraelit, konflikti Izrael-Hamas dhe përmbajtje mashtruese lidhur me pretendime për dhënie kredish apo edhe për produkte me pretendimin se shërojnë sëmundje të ndryshme.


02. TikTok

Përmbajtje mashtruese (9%), përfshirë këtu video të manipuluar, si dhe dezinformata (7%) janë dy kategoritë kryesore që kanë dominuar gjatë monitorimit dhe gjetjeve të keqinformatave në muajin prill (2024). Politika (12%), socialja (5%) dhe siguria (5%) janë tre kategoritë për të cilat u keqinformua më së shumti në platformën TikTok. Sa u përket temave, janë publikuar sondazhe zgjedhore pa autor, një statistikë manipuluese për besimin në qeverinë aktuale, si dhe dy video të edituara të Dardan Molliqajt nga PSD dhe ish-presidentit, Hashim Thaçi me pretendime se flasin fjalë vlerësime për kryeministrin, Albin Kurti.

Figurat dhe institucionet më të përfolura

Kjo matje analizon të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura përmes monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.


RENDITJA E INSTITUCIONEVE MË TË PËRFOLURA SIPAS PËRQINDJES



Në bazë të përmbajtjeve keqinformuese të gjetura dhe trajtuara për muajin prill 2024, në të cilat janë përmendur institucionet, rezulton se në 4 përmbajtje keqinformues janë përfshirë 3 institucione. Në mesin e këtyre institucioneve të përmendura mbizotëron Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, e cila është përmendur në dy teori konspirative. Incidenti në Lagjen e Boshnjakëve dhe rrahje në veri ku janë të përfshirë qytetarët e komunitetit serb, kjo Zyrë, i interpreton pa fakte si projekt i Prishtinës zyrtare për spastrim etnik të serbëve.

Institucionet e sigurisë, FSK dhe NATO u përmend nga një herë në përmbajtjet e gjetura gjatë muajit prill. FSK është përmendur në përmbajtjen dezinformuese të publikuar në TikTok ku automjetet e forcave të armatosura të Gjermanisë “Bundeswehr” paraqiten rrejtshëm si pajisje të FSK-së. Ndërsa NATO u përmend në një përmbajtje të publikuar në Facebook me pretendimin e rremë se dizajni i objektit të selisë së NATO-s në Bruksel paraqet simbolet naziste SS.

RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFLOR SIPAS PËRQINDJES



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është figura më e përfolur (në 4 keqinformata) në kontekst me personalitete tjera, në 28 përmbajtje keqinformuese ku janë përfolur personalitetet. Kurti u përfol së bashku me ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi dhe kryetarin e PSD-së, Dardan Molliqaj, ku nëpërmjet videove të manipuluar pretendohet se Thaçi dhe Molliqaj thonë fjalë vlerësuese për Kurtin. Kurti u përfol së bashku me Milan Radojčić, ish- nënkryetar i Listës Serbe dhe njëherit pjesë e listës së zezë të SHBA-ve dhe Britanisë së Madhe, ku u publikua përmbajtja e vjetër e kërcënimit të Radojčićit ndaj Kurtit, si aktuale. Kurti u përfol edhe së bashku me kryeparlamentarin, Glauk Konjufca dhe presidenten, Vjosa Osmani, në lidhje me deklarimin e pasurisë e që u Raportua gabimisht se Konjufca ka 100 mijë herë më shumë para në banka se Kurti e Osmani.

Ish-presidenti i SHBA-ve, tashmë i ndjerë, John Kennedy, është përfolur në dy përmbajtje keqinformuese të publikuara në mediat sociale, nëpërmjet së cilave është pretenduar se ai është gjallë. Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, po ashtu është përfolur në dy përmbajtje keqinformuese të publikuara në media sociale, ku janë publikuar dy imazhe të gjeneruara me inteligjencë artificiale e që njëra e shfaq kryeministrin izraelit të shtrirë në spital, tjetra, afër një mështjerre si “mesazh” për xhaminë Al-Aksa.

Të gjithë personalitet tjera, janë përfolur nga një herë në përmbajtjet keqinformuese të publikuara gjatë muajit prill. Nëse vlen të përmendet, futbollisti kosovar, Vedat Muriqi, u përfol në pretendimin e paverifikuar për ngritjen e një murali të tij në qytetin e Mallorcas. Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić u përfol nga portalet informative lidhur me deklarimin e tij në Këshill të Sigurimit, ku pati huqje në përkthimin shqip të deklaratës së Vučićit me pretendimin se e përmend bashkëshortin e presidentes Osmani.

Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave

Hibrid.info, përveç kontrollit dhe analizës së artikujve mediatik, bën edhe kontrollin dhe vlerësimin e deklaratave të zyrtarëve të lartë politikë e institucionalë, si dhe figurave që kanë ndikim publik. Vlerësimi i këtyre figurave, sipas metodologjisë së hibrid.info, bëhet në kategoritë e vërtetësisë, qëndrueshmërisë dhe përmbajtjes së premtimeve.

RENDITJA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT TË DEKLARATAVE

Mbajtje e pjesshme e premtimit

Sociale

Biçikletat në kryeqytet

Alban Zogaj

Në kuadër të përmbajtjes së monitoruar gjatë muajit prill, “hibrid.info” ka kontrolluar dhe analizuar një deklaratë.

Për ardhjen e biçikletave të qytetit në Prishtinë, kishte njoftuar më 5 dhjetor të vitit 2023, nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Alban Zogaj, në llogarinë e tij në Facebook. Në këtë njoftim, Zogaj kishte paralajmëruar montimin e stacioneve gjatë javëve në vijim, kurse sipas të njëjtit, biçikletat do të jenë të gatshme për përdorim, në pranverë. Pas kontrollit nga hibrid.info, është vërtetuar se që nga ardhja e biçikletave, nuk është parë ende asnjë rezultat konkret, që i bën ato në dispozicion për shfrytëzim nga qytetarët.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në baza të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjithë artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben si një ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore, dhe atë në formë kryesisht kuantitative, për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese një mujore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër çrregullimit informativ. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar - IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 30 prill 2024, në të cilën janë trajtuar 68 përmbajtje keqinformuese.

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes një mujore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit prill 2024, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

Gjatë muajit prill janë gjetur dhe trajtuar 68 përmbajtje keqinformuese, ku është evidentuar se dezinformatat kanë qenë kategoria kryesore e keqinformimit, me 25% të të gjitha përmbajtjeve keqinformuese. Kjo për faktin se që gjatë këtij muaji, keqinformacioni nuk është përqendruar në një temë specifike që ka marrë përqendrimin kryesor, por disa përmbajtje keqinformuese me tematikë politike dhe të sigurisë janë vlerësuar si dezinformatë. Kjo kategori pasohet, nga përmbajtjet e paverifikuara me 22%, ndërsa mashtrimi është radhitur me 15%.

Si rezultat i sulmit me dronë në mesnatën e 13 prillit nga ana Iranit drejt Izraelit, ka ndikuar që të mbizotërojnë video të paverifikuara të publikuara nga faqet të ndryshme në mediat sociale lidhur me këtë temë. Publikimi i këtyre videove nga zhvillime tjera me pretendimin se paraqesin momente nga sulmi i Iranit drejt Izraelit, tregon se këto zhvillime ndërkombëtare me peshë përdoren për të keqinformuar nga faqe dhe llogari që gjenerojnë përmbajtje në gjuhën shqipe në media sociale. Përderisa, konflikti Izrael-Hamas po vazhdon, kjo temë ka vazhduar të përdoret për të keqinformuar nga faqe në Facebook edhe gjatë muajit prill. Gjatë prillit u publikuan edhe përmbajtje të koduara si raste tragjike për të cilat nuk bëhet e ditur në titull vendndodhja e ngjarjes. Krahas këtyre përmbajtjeve janë publikuar edhe përmbajtje mashtruese me pretendime të rreme për dhënie kredish dhe produkte që shërojnë sëmundje të caktuara.

Publikimi i keqinformatave në një gamë të gjerë temash sociale si çmimi i bukës, pensionet, dhënia e kredive, emigrimi, produkte shëruese, sigurimi shëndetësor etj., ka bërë që kjo fushë të prijë gjatë muajit prill me 29%. Pjesa e konsiderueshme nga fusha sociale janë vlerësuar si mashtrim (9%), përmbajtje e paverifikuar (6%), clickbait (4%) dhe dezinformatë (4%). Për shkak se temat si, sulmi i Iranit ndaj Izraelit, zhvillimet në veri dhe vendbanimet me shumicë serbe, kërcënimi i ISIS dhe të tema të tjera për të cilat u keqinformuar janë nga fusha e sigurisë ka ndikuar që kjo fushë të radhitet si e dyta me 28%. Shumësia e përmbajtjeve keqinformuese nga kjo fushë janë vlerësuar si dezinformatë (10%), përmbajtje e paverifikuar (9%) dhe teori konspirative (4%). Temat të ndryshme ndërlidhur me politikën si, anëtarësimi i Kosovës në KfE,

Kosova dhe BE, Këshilli i Sigurimit, e tema të tjera janë përdorur për të keqinformuar gjatë muajit prill, duke bërë që kjo fushë të radhitet si e treta më 26%. Këto përmbajtje keqinformuese nga fusha politike janë vlerësuar si, dezinformata (9%), mashtrim (6%), lajm i rremë (4%) etj.

Bazuar në gjetjet dhe trajtimet e përmbajtjeve keqinformuese, vërehet një rritje prej 5% të keqinformacioneve të publikuara në media sociale krahasuar me muajin mars (nga 61% në mars 2024, në 66% në muajin prill 2024). Kjo mund të shpjegohet nga fakti se pothuajse të gjitha dezinformatat, një pjesë e konsiderueshme e përmbajtjeve të paverifikuara, dhe të gjitha përmbajtjet mashtruese dhe lajmet e rreme janë publikuar në media sociale. Gjatë muajit prill, 77% e përmbajtjeve keqinformuese në mediat sociale janë publikuar në Facebook, ndërsa 23% në TikTok.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është figura më e përfolur (në 4 keqinformata) në kontekst me personalitete tjera, në 28 përmbajtje keqinformuese ku janë përfolur personalitetet. Ai u përfol së bashku me ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, dhe kryetarin e PSD-së, Dardan Molliqaj, ku nëpërmjet videove të manipuluar pretendohet se Thaçi dhe Molliqaj thonë fjalë vlerësuese për Kurtin. Po ashtu, Kurti u përfol së bashku me Milan Radojçiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe dhe njëheritë pjesë e listës së zezë të SHBA-s dhe Britanisë së Madhe, ku u publikua përmbajtja e vjetër e kërcënimit të Radojçiqit ndaj Kurtit, si aktuale. Gjithashtu, Kurti u përfol edhe së bashku me kryeparlamentarin, Glauk Konjufca, dhe presidenten, Vjosa Osmani, në lidhje me deklarimin e pasurisë, duke raportuar gabimisht se Konjufca ka 100 mijë herë më shumë para në banka se Kurti dhe Osmani.

Në kuadër të kontrollit të deklaratave dhe premtimeve është trajtuar njoftimi për ardhjen e biçikletave të qytetit në Prishtinë, bërë më 5 dhjetor të vitit 2023, nga nënkryetari i Komunës së Prishtinës, Alban Zogaj, në llogarinë e tij në Facebook. Në këtë njoftim, Zogaj kishte paralajmëruar montimin e stacioneve gjatë javëve në vijim, kurse sipas të njëjtit, biçikletat do të jenë të gatshme për përdorim, në pranverë. Pas kontrollit nga hibrid.info, është vërtetuar se që nga ardhja e biçikletave, nuk është parë ende asnjë rezultat konkret, që i bën ato në dispozicion për shfrytëzim nga qytetarët.

HIBRIDO.INFO